

INSTRUKSIONE PËRDORIMI TË DATABAZËS SË KRIMEVE ZGJEDHORE

Hartësimi i krimeve të pretenduara zgjedhore përfshihet për herë të parë si një komponent apo tematike në monitorimet zgjedhore. Mjeti kryesor i hartëzimit është një sistem të dhënash që mbledh dhe shfaq të gjitha krimet e pretenduara, sipas parashikimve që përmban kreu X I Kodit Penal, të ndryshuar. Tabela kryesore, ose Databaza e Kallzimeve Zgjedhore mbledh dhe shfaq të dhëna që indikojnë kallzime apo referime në 21 prokurorite e rretheve. Për herë të parë, kjo Databazë diferencon edhe kallzimet penale të depozituara në SPAK.

Databaza përmban 12 kolona për momentin (numri mund të rritet më vonë). Më poshtë, ofrohet një shpjegim për të kuptuar të dhënat e përmbajtjes për secilën kolonë në veçanti, si dhe për lidhjen e të dhënave të paraqitura në një mënyrë gjithëpërfshirëse për të vlerësuar fenomenin e krimeve zgjedhore në përgjithësi.

Në kolonën e parë "numri indeksues/index number", renditen të gjitha çështjet që janë paraqitur në zyrat e prokurorisë. Atyre u është dhënë një indeks / numër serial. Numri i fundit i papërpunuar përfaqëson gjithashtu numrin e përgjithshëm të rasteve që janë vërejtur nga vëzhguesit e INFOÇIP në kohë këto zgjedhje parlamentare.

Në kolonën e dytë shfaqen të dhënat lidhur me kohën/datën kur kallëzimet penale të paraqitura janë dorëzuar në Prokurori. Në rastet e referuara në Prokurori nga Policia, data korrespondon me atë të njoftimit zyrtar të shpërndarë në media. Në rast se çështja është identifikuar merret direkt nga vëzhguesit e INFOÇIP, data korrespondon me raportimin e botuar në Platformën www.krimizgjedhor.com

Në kolonën e tretë "Subjekti" tregohet subjekti që ka ngritur kallëzimin penal. Kjo kolonë ofron një kuptim të qartë mbi subjekti / institucionin më aktiv në ngritjen e akuzave penale kundër personave / subjekteve të përfshirë në blerjen e perceptuar / dyshuar të votës ose devijimin e votës.

Në kolonën e katërt "Lloji" shfaqet lloji i ankesës ligjore. Sipas ligjit shqiptar, qytetarët, votuesit, subjekti zgjedhor apo edhe institucionet mund të paraqesin denoncimin në polici, të paraqesin akuza drejtpërdrejt në zyrën e prokurorisë, ose thjesht të ngrënë një shqetësim / sinjal tek autoritetet përgjegjëse të zbatimit të ligjit.

Në kolonën e 5-të "Depozituar nga" paraqitet emri i personit / subjektit që ka ngritur kallëzimet penale ose institucionit që ka përcjellë ankesën e qytetarëve tek autoritetet e zbatimit të ligjit

Në kolonën e 6-të "Numri i të kallzuarve", paraqitet një vlerësim për numrin e përgjithshëm të personave të akuzuar në çështjen që është paraqitur pranë organit të prokurorisë.

Në kolonën e 7-të "Referuar në (Prokuroria)", e theksuar me të verdhë, përdoruesit të kësaj databaze i jepet lokacioni i prokurorisë ku janë paraqitur denoncimet ose akuzat penale të ngritura për krime të dyshuara zgjedhore. Për herë të parë në Zgjedhjet e 2021, SPAK (Struktura e Posaçme Antikorrupsion) ka juridiksion mbi 2 nga 15 figurat e veprave penale të përshkruara nga Kreu X i Kodit Penal, të ndryshuar. Kolona e 7-të shërben në këtë këndvështrim për të bërë një dallim midis çështjeve të paraqitura për hetim në prokuroritë normale (të rretheve) në krahasim me ato të paraqitura në SPAK.

Në kolonën e 8-të "Evidencat Fillestare", INFOCIP ka siguruar provat faktike të akuzave të ngritura për vepra penale të supozuara që mund të kenë cënuarzgjedhjet e lira dhe të ndershme. Çdo qelizë e kësaj kolone ka një buton të gjelbër të lidhur me link, që pasi të shtypet shfaq (paraqet / hap) faqen e parë të kallzimit penal të depozituar. Të gjitha faqet e para janë anonimizuar paraprakisht nga INFOCIP.

Në kolonën e 9-të "Mënyra e zgjidhjes", databaza ka veçuar hapësirën për të pasqyruar rezultatin e hetimit penal për secilën nga rastet e paraqitura. Akronimi: NPV do të thotë: Nën Proces Verifikimi. Kjo kolonë pritet të kompletohet nga 18 ditë deri në 6 muaj nga paraqitja e ankimit, siç parashikohet nga afati procedural i hetimit i rregulluar nga Kodi i Procedurës Penale.

Në kolonën e 10-të, "Nenet" paraqiten nent e Kodit penal që janë referuar në çdo kallzim penal të depozituar.

Në kolonën e 11-të "Bashkia", baza e të dhënave ofron vendin ku janë konsumuar ose konsumar fillimisht incidentet apo shkeljet apo pretendimet për krime zgjedhore. Kjo siguron një kuptim të gjeografisë së krimeve të pretenduara. Shqipëria ka 61 bashki në total.

Në kolonën e 12-të "Qarku" tregon rajonin zgjedhor ku kanë ndodhur krimet elektorale të dyshuara/supozuara. Shqipëria ka 12 "Qark" Zgjedhore / Rajone. Sistemi zgjedhor në Shqipëri është proporcional rajonal.

Përveç Tabelës kryesore, e cila është e pasur në përmbajtje grafike dhe lejon linkimin e dëshmive/kallzimeve/referimeve, INFOCIP u ka siguruar përdoruesve të kësaj databaze edhe një Tabelë në Open Data, identike në përmbajtje me tabelën kryesore, përveç linkeve. Kjo tabelë e dytë ofron një avantazh për të përdorur mjete shtesë për shkarkimin e tabelës në Excel, word ose format tjetër për përpunim më të mirë të të dhënave, renditjen e tyre, filtrimin etj.